



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

*Nr. 126 Datë 29.08.2012*

**MBI**

**ANKIMIN ADMINISTRATIV TË CEZ SHPËRNDARJE SH.A NË LIDHJE  
ME VENDIMIN NR. 102, DATË 19.07.2012 “PËR MIRATIMIN E  
MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE  
MIDIS OST SH.A DHE CEZ SHPËRNDARJE SH.A” BORDIT TË  
KOMISIONERËVE**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me Vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.08.2012, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi ankimin administrativ të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a për vendimin nr. 102, datë 19.07.2012,

**Vendosi:**

1. Të mospranojë ankimin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në një vendim të ndryshëm nga ai i marre në datën 19.07.2012, dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 102, datë 19.07.2012 “Për miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.